



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 29

Tiranë – E hënë, 2 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 4.2.2015	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për ngritjen e varrezave private..... 1321
Urdhër i Kryeministrit nr. 27, datë 24.2.2015	Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për verifikim dhe kontrollin e sipërfaqes shtetërore dhe private në të gjithë zonën bregdetare që përfshihet në territorin e bashkive Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol..... 1322
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 8, datë 25.2.2015	Për shpalljen e thirrjes së dytë për ndarjen e fondit për arsimin, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve 1323
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 16.2.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 1105, datë 3.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 448, datë 15.3.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 8408, datë 6.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë..... 1328
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 16.2.2015	Me objekt shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv”, të ndryshuar..... 1332
Vendim i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 20, datë 23.2.2015	Për revokim të vendimit të AMA-s nr. 8, datë 26.3.2014 “Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim””..... 1342

**VENDIM****Nr. 151, datë 4.2.2015****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË PROCEDURAVE
PËR NGRITJEN E VARREZAVE
PRIVATE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 3/b, të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për varrezat private, të cilat ngrihen nga subjekte private, mbi troje në pronësi të tyre ose në troje në pronësi shtetërore, a të njësisë bazë të qeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Ngritja e varrezave private bëhet me miratimin e këshillit të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe/ose të Këshillit të Ministrave.

3. Propozimet e subjekteve private për ngritjen e varrezave private, mbi troje në pronësi të tyre ose në troje në pronësi shtetërore, a të njësisë bazë të qeverisjes vendore, shqyrtohen nga administrata e njësisë bazë të qeverisjes vendore ose e ministrisë përgjegjëse për çështjet e zhvillimit urban, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e depozitimit të tyre. Për këtë qëllim ngrihet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ngritjen e varrezave private, i cili ka detyrë shqyrtimin e propozimeve, përgatitjen e komenteve dhe analizave për titullarin e institucionit, hartimin e projektakteve, sipas rastit dhe nevojës, si dhe negociimin dhe përgatitjen për nënshkrim të marrëveshjes për ngritjen dhe funksionimin e varrezës private. Ky komision funksionon deri në përfundim të procedurës.

4. Komisioni verifikon propozimin, bazuar në ligjin nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, në rregulloren “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, dhe në rregulloren “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 712, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave.

5. Komisioni kontrollon dhe evidenton përputhshmërinë edhe me strategjinë e zhvillimit territorial rajonal të vendit, planet e përgjithshme vendore, si dhe, në rast se zhvillimi i projektit kërkon ndërhyrje dhe reflektim në këto dokumente, propozon hapat dhe rrugën ligjore për përputhshmërinë e tyre.

6. Kur propozimi plotëson kushtet sipas ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, dhe rregullave të miratuara me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 29.10.2014, “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë””, dhe nr. 712, datë 29.10.2014, “Për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë””, kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore ose, sipas rastit, ministri përgjegjës për çështjet e zhvillimit urban i dërgon për miratim, sipas rastit, këshillit të njësisë bazë të qeverisjes vendore ose Këshillit të Ministrave projektvendimin për ngritjen e varrezës private dhe autorizimin e kryetarit të njësisë, ose, sipas rastit, ministrit për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me subjektin privat. Në rastet kur propozimi parashikon ngritjen e varrezës në truall në pronësi shtetërore ose të njësisë bazë të qeverisjes vendore, vendimi duhet të përmbajë dhe dispozitën për kalimin e truallit në përdorim të subjektit privat dhe administrimin e tij sipas marrëveshjes.

7. Subjekti privat ushtron veprimtarinë e tij në bazë të marrëveshjes së lidhur, sipas rastit, me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore ose ministrin përgjegjës për çështjet e planifikimit urban, në përputhje me ligjin nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, dhe rregullat e miratuara me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 29.10.2014, “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë””, dhe nr. 712, datë 29.10.2014, “Për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë””.

8. Marrëveshja duhet të përmbajë në mënyrë të shprehur të paktën këto klauzola:



a) Të drejtat e specifikuara të kontrollit që ushtron njësia e qeverisjes vendore, detyrimi i subjektit privat për të siguruar akses mbi territor dhe dokumentacion;

b) Përcaktimin e saktë të zonës së rezervuar, statusit ligjor të saj dhe, nëse subjekti privat ngarkohet me përgjegjësi ruajtjeje dhe administrimi mbi të, rrethin e këtyre përgjegjëse;

c) Përcaktimin e saktë të sipërfaqes dhe vendndodhjes së truallit të varrezës dhe tagrat që i kalojnë subjektit privat mbi të;

ç) Detyrimet respektive të palëve për përputhjen e projektit me strategjinë e zhvillimit territorial rajonal të vendit, planet e përgjithshme vendore, me afate të specifikuara për hapat ligjorë që do të ndiqen për të qenë në përputhje, në rast se zhvillimi i projektit kërkon ndërhyrje dhe reflektim në këto dokumente;

d) Llojet e varrimit që lejohet të kryhen në varrezën private të subjektit;

dh) Tërësinë e shërbimeve të drejtpërdrejta apo të lidhura me shërbimin e varrimit që merr përsipër të kryejë subjekti privat në varrezën e tij;

e) Kushtet e përgjithshme të kontratave për të drejtën e përdorimit të varrit, veçanërisht për kohën e prehjes dhe afatin e përdorimit të varrit, që do aplikojë subjekti privat në varrezën e tij;

ë) Rregullat për mbajtjen e të dhënave personale;

f) Procedurat e rinegociimit të marrëveshjes, rrethanat dhe procedurat për suksesionin ligjor të subjektit privat, si dhe

g) Fondet dhe garancitë respektive në rast mbylljeje ose prishjeje të varrezës, për mirëmbajtjen dhe administrimin në periudhën e ndërmjetme.

9. Marrëveshja sipas pikës 8 nënshkruhet nga palët jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga data e vendimit të këshillit të njësisë bazë të qeverisjes vendore ose Këshillit të Ministrave për miratimin e ngritjes së varrezës private.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR

Nr. 27, datë 24.2.2015

PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR VERIFIKIM DHE KONTROLLIN E SIPËRFAQES SHTETËRORE DHE PRIVATE NË TË GJITHË ZONËN BREGDETARE QË PËRFSHIHET NË TERRITORIN E BASHKIVE VLORE, HIMARË, SARANDË DHE KONISPOL

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për verifikimin dhe kontrollin e sipërfaqes shtetërore dhe private në të gjithë zonën bregdetare që përfshihet në territorin e bashkive Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol.

2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ketë në përbërje anëtarë:

- 3 përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

- 3 përfaqësues nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra përkatëse vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

- 1 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit;

- 1 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;

- 1 përfaqësues nga Task – Forca për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore;

- 3 përfaqësues nga ALUIZNI, qendror dhe vendor;

- 1 përfaqësues nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;

- 1 përfaqësues nga Prefektura Vlorë;

- 1 përfaqësues nga Bashkia Vlorë;

- 1 përfaqësues nga Bashkia Himarë;

- 1 përfaqësues nga Bashkia Sarandë;

- 1 përfaqësues nga Bashkia Konispol.



3. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të dërgojnë, brenda 5 (pesë) ditëve, emrat e personave përfaqësues pranë kryetarit të grupit të punës.

4. Detyrat kryesore të grupit ndërinstitucional të punës janë:

- Verifikimi i sipërfaqeve shtetërore e private brenda zonës bregdetare, të cilat përfshihen në territorin e bashkive Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol;

- Identifikimi i zonave informale dhe kërkesat për legalizim brenda këtyre sipërfaqeve.

5. Grupi ndërinstitucional i punës, për përmbushjen e detyrave të ngarkuara, të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin ekzistues dhe atë që do t'u vihet në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, të kryejnë vizitat në terren dhe të bashkërendojnë punën me të gjitha institucionet shtetërore që lidhen me këtë veprimtari.

6. Ngarkohet grupi ndërinstitucional i punës, që, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të përfundojë detyrën e ngarkuar dhe t'i paraqesë Kryeministrit materialin e përgatitur sipas përcaktimeve të pikave 4 e 5, të këtij urdhri.

7. Ngarkohet kryetari i grupit ndërinstitucional të punës për njoftimin e anëtarëve për mbledhjen e parë të këtij grupi.

8. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për koordinimin ndërinstitucional për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 8, datë 25.2.2015

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË
DYTË PËR NDARJEN E FONDIT PËR
ARSIMIN, PJESË E FONDIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së dytë për ndarjen e fondit për projekte të nënprogramit të arsimit, në vlerën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve për vitin 2015. Kjo thirrje për aplikim përfshin projekte për ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave të sistemit të arsimit bazë dhe të mesëm të përgjithshëm.

2. Aplikimi për fonde të thirrjes së dytë për financimin e projekteve në fushën e arsimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur. Institucionet aplikuese janë njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

3. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e aplikuara, sipas kalendarit dhe formularit të dhënë në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet pranë sekretariatit teknik përkatës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.



SHTOJCË I
KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekt-aplikime për projekte në nënprogramin e arsimit.
Jo më vonë se data 10 Mars	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimin e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon: a) Programi i Arsimit 2. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
1 ditë nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës (Ministria e Arsimit dhe Sportit)	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik përkatës (Ministria e Arsimit dhe Sportit)	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar.
1 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i përputhshmërisë me strategjitë përkatëse kombëtare sipas pikës B, shtojca III.
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve
1 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati i përgjithshëm	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e financimit për projekte të inovacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si pjesë e FZHR.

Shënim – Procesi i vlerësimit

- Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik, i ngritur pranë ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2015.
- Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kriterëve të përcaktuara në pikën A, të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.
- Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B, të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit.



SHTOJCA II FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTE

Ky format plotëshet për të gjitha projektet.

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes qendrore ose vendore, autoritetet dhe agjensitë zhvillimore, institucionet e pavarura etj.
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet cili është Programi ku bën pjesë projekti : 1. Programi i Arsimit
Nënprogrami i projektit (*)	Të përcaktohet nënprogrami i projektit (Arsimi bazë, i mesëm i përgjithshëm, profesional)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrimi i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistuese (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërhjryjeve shtesë (sistem ngrohje, mur rrethues, etj.) në objektin ekzistues (nëse ka); - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Rrisqet për zbatimin e tij, - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nqs parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj.)
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhjryje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	- Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen, etj.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore, apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	Paraqisni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, apo nga donatorë.



Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe përfundojë zbatimin i punimeve
Dokumentet e miratimit të projektit nga Njësia e Qeverisjes Vendore (*)	Të paraqiten dokumente për të vërtetuar nëse projekti paraqet: - Vendim të bordit kolegjal drejtues (në rast se është agjensi zhvillimi) - Vendim të këshillit drejtues të njësisë vendore (komunës/qarkut/bashkisë), për miratimin e sheshit të ndërtimit, dhe ndërtimit të projektit; - Është përfshirë në listën e miratuar nga Këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi); - Është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara, nga institucioni përkatës (nqs aplikohet nga institucion qendror) Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkangjitet një kopje e vendimit/dokumentave të tjerë.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo komunës) - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'loj plani) Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik - preventivin - argumentimin teknik përllëgjitje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.



Shënim: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- Me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit pranë sekretariatit teknik përkatës (Ministria e Arsimit dhe Sportit)

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik përkatës, si dhe listën e projekteve të aplikuar. Projektet e aplikuar duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

SHTOJCA III KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kriteret përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë** i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014. Këto kriteret konsistojnë në standardet teknike të domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt zbatimi.

Kriteret për vlerësimin teknik të projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i projektit dhe preventivi është përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim nga **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet **me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

3. Ndikimi i projektit në shërbimet publike ndaj qytetarëve dhe biznesit, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillimin ekonomiko-social, në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimit dhe zhvillimit të aftësive, që vlerësohet **me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**, duke plotësuar dy prej komponentëve, si më poshtë vijon:

Niveli i ndikimit të projektit:

a) në shërbimet bazë, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillim social të zonës në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimit dhe zhvillimit të aftësive. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**

b) Në nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në infrastrukturën arsimore, duke adresuar edhe shkakun. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë.**

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të Institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet **me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**

6. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i fizibilitetit, analiza kosto - përfitim, etj. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet **me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë.**

7. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet **me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**

8. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet **me pikë nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë.**



B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Këto kriteret përdoren nga Sekretariati i Përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar, në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me, maksimalisht, 30 pikë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. Niveli i potencialit për nxitjen e ekonomive lokale dhe zona të përmirësuara të biznesit; krijimi i poleve të zhvillimit urban të qëndërqarqeve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë**.

2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëri dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit që paraqet projekti. Niveli i ndikimit për zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë**.

VENDIM

Nr. 6, datë 16.2.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Sokol Berberi	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 09.10.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 35/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Llambi Avale

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia Tiranë, shoqëria e ndërtimit “Alsion” sh.p.k., Myftar Ahmetaj

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 1105, datë 3.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 448, datë 15.3.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe nr. 8408, datë 6.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe të nenet 27, 28 dhe 30 të ligjit 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të kërkesit, Llambi Avale, që kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë së ndërtimit “Alsion” sh.p.k., që kërkoj rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesi Llambi Avale është pronar i vetëm i sipërfaqes së truallit prej 916 m² dhe i lokalit dykatësh të ndërtuar mbi të, të ndodhura në rrugën “Muhamet Gjollështa”, Tiranë. Në datën 2.7.2001 është lëshuar leja e ndërtimit për shoqërinë tregtare “Alsion” sh.p.k. Kërkesi, duke pretenduar se leja e ndërtimit cenonte pronën e tij, duke mos respektuar kushtet urbanistike dhe distancat me pronën kufitare, ka paditur në gjykatë Bashkinë Tiranë dhe shoqërinë tregtare “Alsion” sh.p.k., duke kërkuar shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ të Bashkisë Tiranë, lejes së ndërtimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8408, datë 6.10.2008, ka rrëzuar kërkesëpadinë e kërkesit Llambi Avale. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 448, datë 15.3.2010, ka lënë në fuqi vendimin nr. 8408, datë 6.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1105 datë, 3.5.2012, nuk ka pranuar rekursin e kërkesit Llambi Avale.

II

3. Kërkesi Llambi Avale i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 24.04.2014 me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së



Rrethit, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

3.1 Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë kanë cenuar parimin e arsytimit të vendimeve.

3.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve, ka cenuar rëndë procesin. Pretendimet nuk kanë gjetur pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë.

3.3 Vendimet në shkallë të parë, apel dhe Gjykatë të Lartë kanë cenuar standardin e paanshmërisë. Gjyqtarët në shkallë të parë kanë shfaqur mendime dhe komente për vlefshmërinë e provave.

3.4 Në Gjykatën e Apelit Tiranë, megjithëse gjyqtari relator i çështjes ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kërkesa e tij nuk është pranuar, duke cenuar rëndë procesin dhe në kundërshtim me jurisprudencën e KEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

3.5 Është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi kërkesat e kërkuarit nuk janë marrë në shqyrtim ose janë rrëzuar padrejtësisht nga gjykata.

3.6 Në kundërshtim të hapur me përmbajtjen e nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë të gabuar moslegjitimitetin e paditësit në proces.

3.7 Gjykatat i kanë mbështetur vendimet e tyre në prova të pavërteta dhe të pasakta, duke përmendur këtu titullin e pronësisë, vendndodhjen e pronës etj.

4. Subjekti i interesuar shoqëria e ndërtimit “Alsion” sh.p.k, ka parashtruar si më poshtë:

4.1 Kërkuar, Llambi Avale, nuk ka asnjë interes të ligjshëm për kërkesat e tij.

4.2 Kërkuar i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykatës së Apelit dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes me të njëjtin objekt padie. Sipas kësaj kërkesë (të bashkëngjitur parashtrimeve), kërkuar ka hequr dorë nga kërkesëpadia pasi është gjetur zgjidhja me mirëkuptim e konfliktit gjyqësor.

5. Në parashtrimet e tij, subjekti i interesuar ka kërkuar edhe përjashtimin e gjyqtarëve Besnik Imeraj e Gani Dizdari, pasi kanë marrë pjesë në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë në gjykimin e

rekursit të Llambi Avale kundër Myftar Ahmetaj. Ai vendim është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 53, datë 11.07.2013

A. Lidhur me kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese

6. **Subjekti i interesuar**, shoqëria ndërtimore “Alsion” sh.p.k., ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve Besnik Imeraj e Gani Dizdari, me pretendimin se këta gjyqtarë kanë marrë pjesë në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë në gjykimin e rekursit të Llambi Avale kundër Myftar Ahmetaj.

7. Në lidhje me këtë kërkesë, në seancën e datës 16.09.2014, Gjykata Kushtetuese vendosi mospranimin e kërkesës për përjashtimin nga gjykimi i çështjes të gjyqtarëve Besnik Imeraj dhe Gani Dizdari, pasi nuk ndodhemi para kushteve të parashikuara nga neni 37 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

8. Gjyqtari Fatos Lulo ka paraqitur kërkesë me shkrim, përmes së cilës, në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkon heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, pasi ka marrë pjesë në gjykim në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me këtë kërkesë, në seancën e datës 16.09.2014, Gjykata Kushtetuese vendosi mospranimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi të zotit Fatos Lulo, pasi nuk ndodhemi para kushteve të parashikuara nga neni 36/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

B. Për legjitimitimin e kërkuarit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese

9. Individit, në kuptim të neneve 131, shkronja “f”, si dhe 134, pika 1, shkronja “g” dhe pika 2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë, për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike.

10. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vëren se kërkuar legjitimohet (*ratione personae*) e (*ratione materiae*), në kuptim të neneve 131/f dhe nenit 134/1/g të Kushtetutës. Ai legjitimohet, gjithashtu, (*ratione temporis*), në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të



Republikës së Shqipërisë”, “*kërkesa e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqitet jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes*”.

11. Në rastin konkret kërkesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 24.04.2014, ndërsa data e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është 03.05.2012, pra brenda afatit dyvjeçar.

III

Vlerësimi i Gjykatës

C. *Për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Apelit*

12. Kërkesi pretendon se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, megjithëse gjyqtari relator i çështjes ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kërkesa e tij nuk është pranuar duke cenuar rëndë procesin.

13. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 25, datë 11.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (*shih vendimet nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 25 dhe datë 11.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata konstaton se Kryetari i Gjykatës së Apelit, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e gjyqtarit relator për dorëheqje nga gjykimi i çështjes objekt shqyrtimi, ka vendosur në bazë të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile të mos ta pranojë këtë kërkesë, pasi shkaqet e paraqitura nuk janë të ligjshme.

16. Gjykata vlerëson se kërkesi nuk parashtron argumente kushtetuese në lidhje me mungesën e garancive procedurale të mjaftueshme nga gjykatat dhe as në lidhje me praninë e ndonjë interesi personal të gjyqtarëve në atë proces. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesit për cenimin e njërit prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut, është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

D. *Për pretendimin për cenimin e parimit të standardit të arsyetimit të vendimit*

17. Sipas kërkesit, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi nuk është shprehur për shkaqet konkrete të mospranimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkesit ka cenuar rëndë parimin e standardit të arsyetimit të vendimit.

18. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata, bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe jurisprudencën e saj, ka nënvizuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 108, datë 03.10.2012 dhe nr. 17, datë 17.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimin nr. 143, datë 07.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

19. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të



nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106 dhe Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 07.12.2010, § 51*).

20. Neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar në paragrafët e tjerë elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (neni 480). Vlerësimi i rekursit është atribut i Gjykatës së Lartë dhe veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 45, datë 23.07.2012; nr. 4, datë 25.02.2009; nr. 5, datë 26.01.2007 dhe nr. 8, datë 02.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nisur nga parashikimet e dispozitave të lartpërmendura të Kodit të Procedurës Civile, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata ka nënvizuar se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë dhe të aksesit në gjykatë, brenda kuadrit të procesit të rregullt ligjor, përmbajtja e vendimit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 26, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Pavarësisht standardeve të arsytimit që karakterizojnë vendimin e marrë në dhomën e këshillimit, Gjykata vëren se në rastin konkret vendimi i mospranimit të rekursit përmban në pjesën hyrëse të tij objektin e padisë, disponimet e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs pala e paditur (kërkuesi), por nuk përmban shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs. Në rekurs kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe atë të Gjykatës së Apelit, si vendime të dhëna në kundërshtim me ligjin. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në pjesën arsyetuese është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij.

23. Duke iu referuar jurisprudencës së saj, Gjykata thekson se pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 15, datë 19.04.2013 dhe nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga analiza në tërësi e vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se për shkakun e lartpërmendur rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme, dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që arsyetimi të mos ketë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsytimit të gjykatës, duke krijuar dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesit. Është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivokë në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesve nga ana e saj (*shih vendimet nr. 28, datë 15.05.2014 dhe nr. 26, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).



24. Nisur nga argumentet e mësipërme, si dhe bazuar në qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese në këtë drejtim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuessit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

E. Për pretendimet e tjera

25. Kërkuessi ka pretenduar se gjykatat i kanë mbështetur vendimet e tyre në prova të pavërteta dhe të pasakta, duke përmendur këtu titullin e pronësisë, vendndodhjen e pronës etj. Gjithashtu, në vendimet e tyre, këto gjykata nuk kanë arsyetuar mbi fuqinë provuese të provave dhe nuk kanë bërë një analizë të plotë të tyre në raport me provat e mbrojtjes. Për rrjedhojë, sipas kërkuessit, është cenuar parimi i barazisë së armëve.

26. Gjykata vlerëson se pavarësisht mënyrës së formulimit të pretendimeve të kërkuessit, në thelb ato kanë të bëjnë me çështje të konstatimit dhe vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur, në mënyrë të vazhdueshme, se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor dhe nuk mund të jetë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 7, datë 27.04.2005, dhe nr. 106, datë 01.08.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Si pasojë, Gjykata çmon se ajo nuk mund të investohet për shqyrtimin e pretendimeve të kërkuessit si më sipër, përderisa ato nuk janë ngritur në nivelin e një gjykimi kushtetues.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuessit, për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve

gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, janë pjesërisht të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash¹,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 1105 datë, 03.05.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 7, datë 16.2.2015

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

¹Gjyqtarët V. Kristo dhe A. Xhoxhaj votuan kundër pranimi të kërkesës, sipas qëndrimeve resektive të shprehura në mendimet e pakicës së vendimit nr. 34, datë 13.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese.



me sekretare Blerina Basha, në datën 25.09.2014, mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 39/9 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Abaz Deda dhe Lorana Kasapi, shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., në mungesë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv”, i ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Neni 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28, 29 e 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj; përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv”, (ligji nr. 8975/2002) i ndryshuar me ligjin nr. 9286, datë 30.09.2004, parashikon se *“fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave, në bazë të nenit 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tij”* (neni 1).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (gjykata referuese) është vënë në lëvizje nga shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Fier” sh.a., në bazë të nenit 511/ç të Kodit të Procedurës Civile (KPC), për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv fatura uji, me qëllim ekzekutimin e detyrimit të palës debitore. Gjatë shqyrtimit të

kësaj çështjeje, gjykata referuese ka vënë në dyshim pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit nr. 8975/2002 dhe, për këtë arsye, me vendimin nr. 3, datë 22.04.2014, ka pezulluar gjykimin e çështjes dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, duke parashtruar këto shkaqe:

2.1 Neni 17 i Kushtetutës nuk është i zbatueshëm për të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe një nga të drejtat që kualifikohet në të drejtat absolutisht të pakufizueshme, është e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës. Në këtë përfundim arrihet po të mbahen parasysh neni 175 i Kushtetutës, si edhe natyra e kësaj të drejte. Kufizimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor do të sillte, në mënyrë të drejtpërdrejtë, privime të pajustificuara të të drejtave dhe lirive të tjera themelore, për sa kohë këto kufizime nuk i nënshtrohen një procesi ligjor.

2.2 Përcaktimi i një akti si titull ekzekutiv do të thotë që ky i fundit t’i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit pa e marrë konfirmimin e ekzistencës së tij përmes një procesi të rregullt ligjor. Procedura për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv kalon fillimisht nëpërmjet nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit nga ana e gjykatës kompetente, gjykim në të cilin nuk thirret pala debitore dhe nuk ka debat mbi provat, pra një procedurë e cila nuk ka elemente për t’u kualifikuar si një proces i rregullt ligjor. Me vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, kreditori, përmes procedurës së ekzekutimit, vë dorë mbi pasuritë e debitorit, pra cenon të drejtën e pronësisë së këtij të fundit. Është e vërtetë se debitori mund të mbrohet më tej me padinë e parashikuar nga neni 609 i KPC-së, por një mbrojtje e tillë është *a posteriori*, ndërkohë që garancia e ofruar nga neni 42 i Kushtetutës, si një mbrojtje *a priori* e të drejtave, është një garanci që duhet të zbatohet në çdo rast.

2.3 Fatura e konsumimit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura është një faturë tatimore shitjeje, e cila pasqyron një veprim juridik ndërmjet dy palëve kontraktuese. Në çdo situatë për furnizuesin është parashikuar mundësia që në rast të mospagesës së saj të ndërpresë furnizimin, edhe si masë për të detyruar blerësin të përmbushë



detyrimet, ose mund t'i drejtohet gjykatës nëse ka pretendime lidhur me këto detyrime.

2.4 Në nenin 510/e të KPC-së është parashikuar se edhe akte të tjera sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë. Rregullimi i marrëdhënieve juridike procedurale gjyqësore, si për fazën e njohjes së të drejtës, ashtu edhe për fazën e ekzekutimit të saj, është bërë nëpërmjet një ligji të përforcuar. Përcaktimi i një akti si titull ekzekutiv mbart në vetvete pasoja për të drejtën e pronës ose të drejta të tjera, pasi një akt i tillë është i ekzekutueshëm mbi pasurinë ose të drejta të tjera të debitorit. Për këtë motiv, përcaktimi si titull ekzekutiv i një akti që nuk parashikohet në nenin 510 të KPC-së mund të bëhet vetëm përmes një ligji të miratuar me të njëjtën shumicë me Kodin, pasi në këtë rast jemi përpara rezervës ligjore të përforcuar.

2.5 Ligji i kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike për shkak të ometimit legjislativ. Ai ka një përmbajtje tërësisht evazive, e cila nuk lë vend për interpretim nga ana e gjyqtarit të zakonshëm. Edhe nga pikëpamja formale e teknikës legjislative, ligji i kundërshtuar nuk përmbush standardet minimale për t'u konsideruar i tillë. Duke mos pasur asnjë nga këto elemente, ligji i kundërshtuar lë të paqartë kuptimin e termit “faturë e konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura”.

3. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, përfaqësuar në gjykim nga Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, ka prapësuar sa vijon:

3.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ajo nuk plotëson kërkesat e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese si *conditio sine qua non* për të kërkuar kontrollin incidental të normës. Ajo nuk ka arritur ta ngrejë kërkesën në nivel kushtetues, duke bërë një analizë të hollë, të thellë, të detajuar e të zgjeruar të normës që pretendon se është jokushtetuese. Gjykata referuese duhej të përpiqej ta zgjidhte çështjen jo vetëm në referim të jurisprudencës të Gjykatës Kushtetuese, por edhe të burimeve të tjera të së drejtës. Po ashtu, gjykata referuese ka shmangur haptazi dispozitat që e lejonin atë ta zgjidhte çështjen në themel.

3.2 Nisur nga fakti se KPC-ja ka trajtuar në mënyrë të njëjtë të gjithë titujt ekzekutivë, kjo kërkesë duhet rrëzuar si gjë e gjykuar, pasi në vendimet e saj nr. 39, datë 16.10.2007 (në lidhje me titujt kredi bankare) dhe nr. 52, datë 05.12.2012 (në lidhje me titujt fatura të energjisë elektrike), Gjykata Kushtetuese është shprehur për tërësinë e këtyre instituteve, duke ezauruar përfundimisht interpretimin kushtetues për procedurën e lëshimit të titujve ekzekutivë.

3.3 Neni 510 i KPC-së parashikon se cilët janë titujt ekzekutivë në bazë të të cilëve mund të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm. Duke iu referuar pretendimeve të paraqitura në kërkesë do të duhej që objekt i saj të ishte kontrolli i kushtetutshmërisë së atyre dispozitave të KPC-së që përcaktojnë procedurën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ndërkohë që ligji i kundërshtuar nuk përcakton në vetvete këtë procedurë, por një akt tjetër për të cilin duhet të zbatohen këto procedura.

3.4 Edhe nëse eventualisht procedura për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit i cenon ndonjë të drejtë debitorit, kjo e drejtë mund të rivendoset nëpërmjet garantimit të një procesi të rregullt bazuar në nenin 609 të KPC-së.

3.5 Pretendimi për cenimin e procedurës së miratimit të ligjeve me shumicë të cilësuar është i pabazuar dhe në tejkalim të arsyes së nevojshme të objektit të kërimit. Vetë Kodi e lejon miratimin e ligjeve që do të përcaktonin tituj ekzekutivë, duke krijuar kështu mundësinë e miratimit të tyre me shumicë të thjeshtë.

3.6 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të ometimit legjislativ, pretendimet e gjykatës referuese nuk janë të mjaftueshme për t'u konsideruar në nivel kushtetues.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

4. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar se gjykata referuese nuk legjitimohet për t'u drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi ajo nuk plotëson kërkesat e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese si *conditio sine qua non* për të kërkuar kontrollin



incidental të normës.

5. Çështja e legjitimitetit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtari çmon se ligji (ose dispozita të tij) bie në kundërshtim me Kushtetutën nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

6. Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimin nr. 39, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 12, datë 14.04.2010; nr. 30, datë 17.06.2010; nr. 7,*

datë 27.02.2013 dhe nr. 39 datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret.

7. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjykata referuese i ka plotësuar kriteret për inicimin e gjyimit incidental. Ajo është vënë në lëvizje nga pala kreditore për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për titujt ekzekutivë, fatura mujore të papaguara të konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura. Edhe pse në raste të tilla gjykata kompetente vihet në lëvizje në bazë të nenit 511 të KPC-së, si dispozita procedurale përkatëse, përcaktimi i faturave të ujit si tituj ekzekutivë është bërë me ligjin nr. 8975/2000, akt i miratuar në zbatim të nenit 510/e të KPC-së. Në këto kushte, ligji i kundërshtuar është ligji i zbatueshëm në rastin konkret. Po ashtu, gjykata referuese ka identifikuar parimet kushtetuese me të cilat, sipas saj, bie në kundërshtim ligji i kundërshtuar, ka identifikuar raportin e domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, si edhe ka argumentuar se nuk ka pasur mundësi të interpretimit të ligjit në pajtim me Kushtetutën dhe se për këtë arsye nuk mund të përdorte mekanizëm tjetër veç atij të paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

8. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet asaj për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 8975/2000, objekt shqyrtimi.

B. Për pretendimin për mosrespektimin e kërkesave të nenit 42 dhe 17 të Kushtetutës

9. Gjykata referuese pretendon se përcaktimi i një akti si titull ekzekutiv, do të thotë që ky i fundit t'i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit



pa e marrë konfirmimin e ekzistencës së tij përmes një procesi të rregullt ligjor. Sipas saj, me vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, kreditori, përmes procedurës së ekzekutimit, vë dorë mbi pasuritë e debitorit, pra cenon të drejtën e pronësisë së këtij të fundit, pa iu nënshtruar një procesi të rregullt ligjor.

10. Gjykata ka vlerësuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor është një nga të drejtat themelore të individit, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, sipas të cilit liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese e ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon se çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paansisë gjatë këtij procesi (*shih vendimet nr. 10, datë 04.04.2007 dhe nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Duke qenë se e drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat themelore të individit, Gjykata duhet të verifikojë nëse në rastin konkret ndodhemi përpara një kufizimi dhe, për pasojë, nëse ai është bërë në respektim të kërkesave të nenit 17 të Kushtetutës.

12. Gjykata vëren se bazuar në nenin 510 të KPC-së, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, i cili në bazë të nenit 511 të KPC-së vihet në ekzekutim me kërkesë të kreditorit dhe për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit. Përveç vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe akteve të tjera të parashikuara në nenin 510 të KPC-së si tituj ekzekutivë, në pikën “e” kjo dispozitë parashikon se të tillë konsiderohen edhe akte të tjera të përcaktuara me ligj të veçantë, ku përfshihen edhe faturat e ujit të pijshëm. Në rast se investohet në bazë të një akti

të tillë, gjykata ka detyrimin të lëshojë urdhrin e ekzekutimit pa vënë në diskutim ekzistencën e detyrimit që kërkohet të shlyhet. Po ashtu, kjo procedurë gjyqësore karakterizohet nga mungesa e një elementi të rëndësishëm të procesit gjyqësor, që është kontradiktoriteti dhe debati gjyqësor, për shkak të mospjesëmarrjes së personave debitorë në të dhe pamundësisë së tyre për t’u njohur me pretendimet dhe provat e palës kërkuese. Gjykata ka vlerësuar se elemente të tilla, që janë thelbësore për zhvillimin e debatit kontradiktor në gjykim, nuk duhet t’i mungojnë procesit gjyqësor përveç rasteve të kufizimit të të drejtave të parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës (*shih vendimin nr. 39, datë 16.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, Gjykata duhet të verifikojë nëse ky kufizim respekton kriteret e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, të cilat janë ekzistenca e një interesi publik dhe të qenit në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar kufizimin.

13. Për sa i përket listës së çështjeve me interes publik, Gjykata ka theksuar se ajo nuk mund të jetë kurrësi shtetërore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen (*shih vendimin nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i shtetit social, i parashikuar që në preambulën e Kushtetutës sonë, e përligj ndërhyrjen e autoritetit publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në marrëdhëniet juridike private për të mbrojtur interesat e përgjithshme, siç janë kontrolli publik i kostos së jetesës, lufta kundër inflacionit, shtytja dhe nxitja e aktiviteteve prodhuese, mbrojtja e shtresave të varfra, promovimi i vlerave sociale, etj. Trajtimet specifike ligjore, me synim që të garantohet akses i çdo individit në mallrat dhe shërbimet bazë/jetike, janë të domosdoshme, sepse këto shërbime ndikojnë në cilësinë e jetës dhe janë një parakusht për gëzimin e shumë të drejtave të tjera themelore të individit (*shih vendimin nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit, Gjykata ka theksuar se ai nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih*



vendimet nr. 10, datë 19.03.2008 dhe nr. 12, datë 28.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Baraspeshimi i ndërhyrjes, me gjendjen që e ka diktuar ndërhyrjen, imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, domethënë të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit (*shih vendimin nr. 25, datë 25.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se metoda e përzgjedhur nga ligjvënësi nëpërmjet cilësimit si tituj ekzekutivë të akteve të ndryshme, nuk është zbatuar vetëm në këtë sektor, por edhe në fusha të tjera. Gjykata ka marrë më parë në shqyrtim aktet ligjore që përcaktojnë si tituj ekzekutivë aktet e dhënies së kredisë bankare si dhe faturat e energjisë elektrike dhe në të dyja këto çështje ajo ka vlerësuar se ligjvënësi ka ndjekur një qëllim të përligjur dhe të justifikuar, në këndvështrimin e konceptit kushtetues “interes publik” (*shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007 dhe nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se edhe pse kjo nuk është forma e vetme për të arritur qëllimin e kërkuar, ligjvënësi këtë formë të atribuimit si titull ekzekutiv të një akti e ka konceptuar si të domosdoshme dhe efektive në disa sektorë me problematika sociale, ekonomike apo dhe fusha me interes të përgjithshëm, të cilat e justifikojnë deri në një farë mase ndërhyrjen nga ana e tij (*shih vendimin nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në të njëjtën linjë me qëndrimet e mëparshme të saj në çështjet e sipërcituara, Gjykata vlerëson se edhe në rastin konkret ligjvënësi ka respektuar ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet interesit publik, nga njëra anë, dhe respektimit të të drejtave të individit për një mbrojtje të plotë ligjore, nga ana tjetër.

17. Gjykata vëren se shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm është një shërbim i decentralizuar, pasi në bazë të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, përgjegjëse për ofrimin e tij në zonat e tyre përkatëse janë njësitë e qeverisjes vendore. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm realizohet nga ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve, të cilat janë “shoqëri aksionare” dhe aksionet e tyre u janë transferuar njërive të qeverisjes vendore. Furnizimi me ujë të pijshëm sigurohet prej burimeve që janë kryesisht puse dhe burime natyrore, të cilat monitorohen nga pushteti qendror, ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve dhe pushteti vendor, me qëllim për t’i shërbyer popullsisë brenda zonave nën administrim.

18. Menaxhimi i kërkesës për furnizimin me ujë lidhet jo vetëm me sigurimin e një furnizimi të vazhdueshëm, sasior dhe cilësor për konsumatorët, por edhe me garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm të furnizimit me ujë, përfshirë edhe mbrojtjen e burimeve ujore, zvogëlimin e humbjeve dhe të sasisë së ujit të pafaturuar në sistem, rritjen e të ardhurave nga faturimi dhe zvogëlimin e shpërdorimeve dhe vjedhjeve në sistem, uljen e kostove, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm financiar të ndërmarrjeve aksionare të ujësjellës-kanalizimeve. Edhe pse mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm është i ndryshueshëm në varësi të shtrirjes demografike dhe lëvizjes së popullsisë në zonat e shërbimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit, përmirësimi i cilësisë dhe aksesit të këtij shërbimi për të gjithë konsumatorët përbën një interes publik. Nëse procedura e mbledhjes së të ardhurave nga konsumi i ujit të pijshëm nuk do të ishte efektive, i gjithë sistemi do të kishte pasoja negative jo vetëm mbi konsumatorët privatë, por edhe konsumatorët e tjerë tepër të rëndësishëm, si spitalet, shkollat, burgjet, etj. Furnizimi me ujë të pijshëm, ashtu si edhe shërbimi i furnizimit me



energji elektrike, si shërbim me interes të përgjithshëm, për vetë specifikën e tij është një shërbim jetik për popullsinë dhe vazhdimësia, cilësia dhe aksesueshmëria e këtij shërbimi duhet t'u ofrohet të gjithë konsumatorëve pa përjashtim, sipas kriterëve specifike ligjore.

19. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se procedura për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nuk është përfundimtare, por ajo përbën një fazë ndërmjetëse, që përgatit palët për fazën eventualisht pasardhëse të shqyrtimit të ekzistencës së detyrimit dhe të shumës së saktë të tij, siç parashikohet në nenin 609 të KPC-së, e cila i njehtë drejtën debitorit *“të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarojë se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas.”* Pra, procedura gjyqësore për shqyrtimin e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv, e parashikuar nga kjo dispozitë procedurale, përbën fazën përfundimtare të zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes. Duke qenë e njëjtë me procedurën gjyqësore që ndiqet për shqyrtimin e çdo padie themeli, ajo krijon të gjitha mundësitë që e drejta eventualisht e cenuar e subjektit të mund të rivendoset nëpërmjet garantimit të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007 dhe nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e neneve 42 dhe 17 të Kushtetutës është i pabazuar.

C. Për pretendimin për mosrespektimin e procedurës së miratimit të ligjeve me shumicë të cilësuar

21. Gjykata referuese pretendon se rregullimi i marrëdhënieve juridike procedurale gjyqësore, si për fazën e njohjes së të drejtës, ashtu edhe për fazën e ekzekutimit të saj, është bërë nëpërmjet një ligji të përforcuar. Sipas saj, përcaktimi i një akti si titull ekzekutiv mbart në vetvete pasoja për të drejtën e pronës ose të drejta të tjera, pasi një akt i tillë është i ekzekutueshëm mbi pasurinë ose të drejta të tjera të debitorit. Për këtë arsye, gjykata referuese pretendon se përcaktimi si titull ekzekutiv i një akti që nuk parashikohet në nenin 510 të KPC-së mund të bëhet vetëm përmes një ligji të miratuar me të njëjtën shumicë me Kodin, pasi në këtë rast jemi përpara rezervës ligjore të përforcuar.

22. Gjykata vëren se në nenin 81/2 të Kushtetutës parashikohet një listë e gjatë e ligjeve,

të cilat duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Gjykata ka theksuar se marrëdhëniet midis ligjeve organike të miratuara me shumicë të cilësuar të Kuvendit dhe ligjeve të zakonshme, të miratuara sipas rregullit të përgjithshëm, mund të shihen në dy mënyra të ndryshme: si marrëdhënie midis burimeve të së drejtës të vendosura në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave ose si një marrëdhënie e bazuar mbi parimin e shpërndarjes të kompetencave. Gjykata ka nën-vijëzuar edhe dallimin që ekziston midis ligjeve organike, që miratohen me shumicë të cilësuar, dhe ligjeve të zakonshme, që miratohen me shumicë të thjeshtë. Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës, ligjet organike ose të cilësuar qendrojnë më lart se ligjet e zakonshme. Nga kjo pikëpamje, ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte (*shih vendimet nr. 9, datë 23.03.2010 dhe nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Procedura e miratimit me shumicë të cilësuar të ligjit nga Kuvendi nuk është vetëm një element formal i procesit legjislativ, por lidhet drejtpërdrejt me parimet e shtetit të së drejtës, të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe të sigurisë juridike. Ligjeve të miratuara me shumicë të cilësuar u është dhënë rëndësi e posaçme në fushën e organizimit dhe të funksionimit të hallkave të ndryshme të organizmit shtetëror, sepse ato rregullojnë marrëdhëniet në një fushë të caktuar, që ligjvënësi nuk mund t'i rregullojë me ligj të zakonshëm. Vullneti i kushtetutbërësit është shprehur mjaft qartë për këtë çështje. Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të këtyre ligjeve, u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve të përforcuara, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenet 6 dhe 81/2 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 03.05.2007 dhe nr. 10, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).



24. Duke ndjekur të njëjtën logjikë, edhe ndryshimet që mund t'u bëhen ligjeve të përforcuara ose dispozitave të veçanta të tyre, nuk mund të arrihen nëpërmjet një ligji të thjeshtë, por nëpërmjet një ligji që do të kërkonte sërish të paktën tri të pestat e deputetëve. Kuvendi nuk mund të miratojë një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë “shumicë të cilësuar”, me “shumicë të thjeshtë”, sepse në këtë mënyrë ligjet që kërkojnë “shumicë të cilësuar” mund ta humbasin rëndësinë e tyre. Nga ana tjetër, referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, kjo ndërhyrje do të cenonte mbrojtjen që garanton neni 81/2 i Kushtetutës (*shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008 dhe nr. 10, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Bazuar në standardet e mësipërme Gjykata vëren se në nenin 1 të KPC-së parashikohet se ai cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në të e në ligje të veçanta. Në këtë kuptim, ligji i kundërshtuar nuk ndërhyr në fushën e rregullimit të KPC-së, pra në të drejtat dhe detyrimet e palëve në procesin gjyqësor civil, rregullat e zbatueshme në çdo fazë të tij apo në kompetencat e gjykatës etj. Ligji objekt shqyrtimi nuk paraqet asnjë disiplinë të re rregullatore, si dhe nuk ndërhyr në marrëdhëniet që rregullohen ekskluzivisht nga KPC-ja apo aspekte të veçanta të saj.

26. Përkundrazi, është vetë KPC-ja që në nenin 510/e të saj i ka deleguar ligjvënësit kompetencën që të miratojë, me ligj të veçantë, edhe akte të tjera që ai do t'i konsiderojë si tituj ekzekutivë, me qëllim arritjen e objektivave të caktuara. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit (*shih vendimet nr. 29, datë 31.05.2010 dhe nr. 43, datë 06.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Është e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kritere të drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete, si dhe me

faktorët e ndryshëm politikë, historikë, socialë, kulturorë e tradicionalë, të cilët janë përcaktues. Megjithatë, duhet të ritheksohet se ligjet ose dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimet nr. 1, datë 07.01.2005; nr. 32, datë 21.06.2010 dhe nr. 28, datë 09.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga kjo pikëpamje, në kushtet kur ligji i kundërshtuar nuk ka trajtuar asnjë nga çështjet që janë parashikuar të trajtohen nga vetë kodi, nga pikëpamja lëndore, Gjykata vlerëson se ai nuk plotëson kushtet për t'u nënshtruar miratimit me shumicë të cilësuar, dhe, për rrjedhojë, pretendimi për mosrespektimin e procedurës së parashikuar nga neni 81/2 është i pabazuar.

D. Për pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

28. Gjykata referuese pretendon se ligji i kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike, për shkak të ometimit legjislativ. Sipas saj ai ka një përmbajtje tërësisht evazive, e cila nuk lë vend për interpretim nga ana e gjyqtarit të zakonshëm, dhe lë të paqartë kuptimin e termit “faturë e konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura”.

29. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, ajo niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi Gjykatës të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimin nr. 16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, gjykata referuese nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të justifikuar se në ç'mënyrë përmbajtja e ligjit të kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike, duke mos arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet për cenimin e sigurisë juridike, si pasojë e trajtimit të faturës së konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv, nuk janë të mjaftueshme për t'i trajtuar ato në nivel kushtetues.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave



të përdorura si titull ekzekutiv”, i ndryshuar, nuk bie në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe, për këtë arsye, kërkesa e paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës, si dhe neneve 68, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtar kundër: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur rrëzimin e kërkesës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier lidhur me antikushtetueshmërinë e ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv”, i ndryshuar. Shumica, duke iu referuar parashtrimeve të gjykatës referuese, ka konstatuar se edhe pse ka kufizim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ligjvënësi ka respektuar ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet interesit publik, furnizimit me ujë të pijshëm, nga njëra anë, si dhe respektimit të të drejtave të individit, për një mbrojtje të plotë ligjore, nga ana tjetër (*shih paragrafët 12 dhe 16 të vendimit*).

2. Shumica, gjithashtu, ka arritur në përfundimin se ligji i kundërshtuar nuk ndërhyr në fushën e rregullimit të KPC-së nga pikëpamja lëndore, arsye për të cilën nuk është e nevojshme që ligji në fjalë t’i nënshtrohet procedurës së miratimit me shumicë të cilësuar (*shih paragrafët 23 dhe 25 të vendimit*). Ndërsa për pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, shumica ka

vlerësuar se gjykata referuese nuk ka sjellë argumente të mjaftueshme për të justifikuar këtë pretendim (*shih paragrafin 27 të vendimit*).

3. Përpjekjet e shumicës për të argumentuar arsyet e rrëzimit të kërkesës i gjej të sforcuara dhe kontradiktore. Ndryshe nga shumica mendoj se Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e saj.

4. Sikurse argumenton edhe shumica, përcaktimi i faturës së ujit të pijshëm si titull ekzekutiv do të thotë që kjo e fundit t’i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit pa u vënë në diskutim ekzistenca e detyrimit që kërkohet të shlyhet (*shih paragrafin 12 të vendimit*). Në këtë mënyrë, parashikimi *a priori* si titull ekzekutivi i faturës së ujit të pijshëm i heq mundësinë konsumatorit për një vlerësim serioz të situatës. Jam i mendimit se ky kufizim i të drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk respekton kriteret e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Pavarësisht nevojës së furnizimit me ujë të pijshëm (interesi publik), ndërhyrja e ligjvënësit nuk është bërë me mjete të përshtatshme që i përgjigjen qëllimit që kërkohet të arrihet (parimi i proporcionalitetit). Organi shtetëror kompetent i ngarkuar me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës në çdo rast të mospagesës së faturës së ujit të pijshëm ka mundësinë të ndërpresë furnizimin me ujë të konsumatorit, çka do të thotë që synimi për të parandaluar në të ardhmen fenomenin negativ të mospëmbushjes së detyrimit për të paguar faturën e ujit të pijshëm mund të arrihet me mjete të tjera më pak të dëmshme për subjektet që cenohen në të drejtat dhe liritë e garantuara nga Kushtetuta (domosdoshmëria e mjeteve).

5. Për sa i përket procedurës së miratimit të ligjit në fjalë, Kushtetuta, në nenin 78, parashikon se Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. Gjykata ka konstatuar se nga rregulli i përgjithshëm i vendimmarrjes me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi bëjnë përjashtim tërësia e ligjeve në lidhje me të cilat, normat kushtetuese, shprehimisht, parashikojnë një shumicë të cilësuar për miratimin e tyre. Konkretisht, hartuesit e Kushtetutës, këtë tërësi ligjesh e kanë renditur në trajtën e një liste shteruese, në nenin 81, pika 2, që përfshin: a) ligjet për organizimin dhe funksionimin



e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta; b) ligjin për shtetësinë; c) ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore; ç) ligjin për referendumet; d) kodet; dh) ligjin për gjendjen e jashtëzakonshme; e) ligjin për statusin e funksionarëve publikë; ë) ligjin për amnistinë; f) ligjin për ndarjen administrative të Republikës së Shqipërisë (*shih vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 dhe nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata ka theksuar se respektimi i kriterëve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta gjatë procedurës ligjvënëse përbën një domosdoshmëri në shtetin e së drejtës. Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve të përforcuara u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye në hierarkinë e akteve ato renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (*shih vendimet nr. 19, datë 03.05.2007; nr. 9, datë 23.03.2010; nr. 23, datë 08.06.2011 dhe nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjithashtu Gjykata ka vlerësuar se raporti midis ligjeve organike ose të miratuara me një shumicë të cilësuar të Kuvendit dhe ligjeve të zakonshme ose të miratuara sipas rregullit të përgjithshëm mund të shihet nga dy këndvështrime: si marrëdhënie midis burimeve të së drejtës, të vendosura në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave - ligjet që miratohen me shumicë të cilësuar qëndrojnë më lart se ato të miratuara me shumicë të thjeshtë- ose si një marrëdhënie e bazuar mbi parimin e shpërndarjes së kompetencës legjislativë. Është pikërisht ky raport që përcakton rregullin se Kuvendi nuk mund të miratojë me “shumicë të thjeshtë” një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë “shumicë të cilësuar”, sepse në këtë mënyrë ligjet që kërkojnë “shumicë të cilësuar” mund ta humbasin rëndësinë e tyre. Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e të drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë (*shih vendimet nr. 19, datë 03.05.2007 dhe nr. 10, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Po në këtë drejtim, Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se ligjet e zakonshme nuk mund të

trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte. Përkundrazi, hartuesit e Kushtetutës, pavarësisht se në formë neni 81, pika 2, shkronja “a”, i Kushtetutës është normë me natyrë procedurale, e përfshijnë parashikimin kushtetues në fjalë, pasi në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, për shkak të rëndësisë të fushave që rregullojnë ligjet e cilësuar, me qëllim për t’i bërë ato sa më të qëndrueshme, për të kërkuar një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend dhe për të shmangur mundësinë që forca politike që ka shumicën të mund të cenojë parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (*shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008; nr. 1, datë 12.01.2011 dhe nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, respektimi i kriterit kushtetues “shumicë e cilësuar” është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike, parim që ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin (*shih vendimin nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Edhe pse standardet e mësipërme kushtetuese janë përmendur në vendimin e shumicës, ajo megjithatë ka arritur në përfundimin se ato nuk zbatohen në rastin konkret përderisa ligji i kundërshtuar nuk ndërhyt nga pikëpamja lëndore në fushat e rregullimit të KPC-së. Në ndryshim nga shumica, jam i mendimit se parashikimi i titujve ekzekutivë në nenin 510, paragrafi i dytë, shkronjat “a” – “dh” të KPC-së, është bërë nëpërmjet një ligji të përforcuar për shkak të rëndësisë së tyre. Në interpretim të shkronjës “e” të këtij neni, i cili parashikon se edhe akte të tjera sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë, vlerësoj se për këtë qëllim me ligje të tjera do të kuptohen ato akte të ligjvënësit që miratohen përmes një ligjit të miratuar me të njëjtën shumicë me Kodin, pra me shumicë të cilësuar prej 3/5-sh të anëtarëve të Kuvendit.

10. Nga sa më lart, çmoj se miratimi me ligj me shumicë të thjeshtë i titujve ekzekutivë të tjerë, përveç atyre të përcaktuar në nenin 510 të



KPC-së, pa respektuar procedurën e parashikuar nga neni 81 pika 2, shkronja “d” e Kushtetutës, është në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës. Sipas nenit 4, pika 1 të Kushtetutës, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Në këtë kuptim miratimi i dispozitave të reja, ndryshimi ose plotësimi i tyre me shumicë të thjeshtë dhe jo me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, përbën një akt që i bie ndesh këtij parimi.

11. Në këtë këndvështrim, mendoj se delegimi që ka bërë ligjvënësi në shkronjën “e” të nenit 510 të KPC-së, për përcaktimin e titujve ekzekutivë edhe në ligje të tjera, ndryshe nga sa arsyeton shumica, nuk është argument për të justifikuar miratimin e dispozitave të reja me ligje të thjeshta. Një delegim i tillë duhet të respektojë në çdo rast parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4, në lidhje edhe me nenin 81, pika 2, të Kushtetutës. Për këtë arsye, ligjvënësi, në çështje të një rëndësie të tillë, për më tepër kur mundësia e arbitraritetit ndaj individit potencialisht është e madhe, duhet të kishte gjetur mekanizmin e përshtatshëm procedural që, në kuadër të garancisë së pronës ose të të drejtave të tjera të debitorit dhe në përputhje me kriteret ligjore për këtë qëllim, të respektonte shumicën e cilësuar prej 3/5-sh në parashikimin e titujve të tjerë ekzekutivë.

12. Ja sepse mendoj se vendimarrja e shumicës, për këtë pretendim të gjykatës

referuese, vendos dy standarde edhe në lidhje me jurisprudencën e lartpërmendur së kësaj Gjykate, si dhe i bie ndesh vullnetit të kushtetëbërësit.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 20, datë 23.2.2015

PËR REVOKIM TË VENDIMIT TË AMA-S NR. 8, DATË 26.3.2014 “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E AMA-S NR. 5, DATË 22.5.2013 “MBI MIRATIMIN E PAGESAVE PËR AUTORIZIM””

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa “f” dhe nenit 25 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, nenit 121, pika 1 dhe nenit 124, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, Autoriteti i Mediave Audiovizive

VENDOSI:

1. Të revokojë vendimin AMA-s nr. 8, datë 26.3.2014 “Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim””.

2. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentian Sala

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë